**SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT TË PROVIMIT TË MATURËS DHE PROVIMIT PROFESIONAL NGA GJUHA SHQIPE DHE LETËRSIA, QERSHOR 2024**

1. Nxënësi/nxënësja* **1 pikë** nëse ka shkruar: *Energjinë bërthamore, përdorimin dhe shfrytëzimin e saj (dhe përgjigje tjera të sakta).*

2. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: *3. informimi*

3. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Energjia bërthamore nuk përdor lëndë djegëse, nuk lëshon gazra toksikë (dhe përgjigje tjera të sakta)*

4. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Instalimi i impianteve afër konsumatorit.*

5. Gjithsej **2 pikë:**

   Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar*: Prodhohet energji, por keqpërdorimi i saj shkakton shkatërrime të paimagjinueshme (dhe përgjigje tjera të sakta)*

   Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë vetëm njërën pjesë të përgjigjes.

6. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Roman social satirik.*

7. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin *1. hipokrit dhe servil.*

8. Gjithsej **2 pikë**:

   Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: *Titulli ka një kuptim simbolik në rrafshin social dhe atë satirik sepse gjilpëra edhe shëron, por njëkohësisht edhe thumbon (dhe përgjigje tjera të sakta).*

   Nxënësi merr **1 pikë** nëse është përgjigjigjur saktë pjesërisht.

9. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar*: Mashtrimi, gënjeshtra, korrupsioni dhe patriarkalizmi (dhe përgjigje tjera të sakta).*

10. Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *mentalitetit/botëkuptimeve të ndryshme.*

---
*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**11.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Forcimi i identitetit kombëtar*

**12.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar: 1. revoltë

**13.** Gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë: *metonimia dhe epiteti.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë njërën figurë stilistike.

**14.** Gjithsej **2 pikë**:

**A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar numrin: *1. Dhimba paduruese që të bajnë të çmendesh*

**B)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar se: *Mjerimi e degradon njeriun deri në çmenduri/ pesha e mjerimit është aq e rëndë sa të bën të çmendesh (dhe përgjigje tjera të sakta).*

***15.*** Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar: *Autori tregon se ku i çon njërin dhe tjetrin personazh zgjedhja që kanë bërë vetë në jetë/ Secili nga ne është përgjegjësi i vetëm për mënyrën se si e ndërton jetën dhe fatin e tij (dhe përgjigje tjera të sakta).*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse përgjigja është pjesërisht e saktë.

**16. Gjithsej 2 pikë:**

**A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar: *3. komedi karakteri*

**B)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar*: Është një komedi karakteri sepse përqeshen personat që e bartin këtë ves asocial (koprracinë) , i cili ua deformon përçudshëm karakterin (dhe përgjigje tjera të sakta).*

**17. Gjithsej 2 pikë:**

**A)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar**:** *Në formë të replikës*

**B)** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar: *Është replikë sepse personazhet në dialog i kundërpërgjigjen menjëherë njëri - tjetrit (dhe përgjigje të tjera të sakta).*

***18.*** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka veçuar ose rrethuar: *kronologjia*

***19.*** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Dy pikat paralajmërojnë një fjali tjetër pasuese, e cila shpjegon më gjerësisht (dhe përgjigje tjera të sakta).*

**20.** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Fjali e ndërmjetme.*

***21.*** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar saktë: *pikësëpari, afërmendsh, i pa të metë.*

**22.** Gjithsej **2 pikë**:

***A)*** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *Kalimtare, folje e rregullt etj.*

***B)*** Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: *saktë argumentin lidhur me përgjigjen e dhënë nën A.*

**23.** Gjithsej **2 pikë:**

Nxënësi merr **2 pikë** nëse ka shkruar saktë: *nga- parafjalë; thellë-ndajfolje; e tyre-përemër; të palumtur- mbiemër.*

Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar saktë tri nga fjalët.

**24. Skema e vlerësimit të tekstit funksional**

| **FORMA DHE PËRMBAJTJA E TEKSTIT** ***3 pikë*** | **GJUHA** ***3 pikë*** | **STILI** ***2 pikë*** |
|---|---|---|
| Të gjitha të dhënat e shkruara në udhëzim janë renditur sipas parimeve të hartimit të tekstit.<br>*3 pikë*<br>Të gjitha të dhënat janë | Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.<br>*3 pikë*<br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore pjesërisht është respektuar, por ka lëshime | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br>Në tekst ka gabime |

| | | |
|---|---|---|
| renditur mirë, por mungon ndonjë e dhënë që e vështirëson kuptimin e tekstit, përkatësisht elementi kryesor që nuk e përmbys formën e tekstit.<br><br>*2 pikë*<br><br>Mungojnë shumë të dhëna, por teksti kuptohet.<br><br>*1 pikë*<br><br>Nuk është respektuar forma e dhënë ose përmbajtja e tekstit është e pakuptueshme.<br><br>*0 pikë* | si:<br><br>- përdorimi i shenjave të pikësimit<br>- përdorimi i drejtë i pjesëve gramatikore<br><br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:<br><br>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura<br>**dhe/apo**<br>- gabon në përdorimin e parafjalëve...<br><br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për | stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.<br><br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...<br><br>*0 pikë* |

| | | |
|---|---|---|
| | alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br><br>*0 pikë* | |

**25. Skema e vlerësimit të esesë:**

**1. Ema Bovari, në mes ëndrrës dhe zhgënjimit**

***Përmbajtja 7 pikë***

| | |
|---|---|
| Respektimi i kërkesave të dhëna | Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:<br>- Zonja Bovari, Gustav Flober, roman psikologjik, letërsia moderne... *(1 pikë)*<br>- ëndërrimtare, pasionante, marrëdhënia e ftohtë bashkëshortore, shkaqet... *(1 pikë)*<br>- kufizimi apo jo i ëndrrave.. *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 3 pikë* |
| Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë... | Krijimi i tekstit:<br>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës *(1 pikë)*<br>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 4 pikë* |

***Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë***

| **GJUHA**<br>***3 pikë*** | **STILI**<br>***2 pikë*** | **FORMA GRAFIKE E TEKSTIT**<br>***1 pikë*** |
|---|---|---|
| Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore. | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në | Përshtatja e organizimit të tekstit |

| | | |
|---|---|---|
| *3 pikë*<br><br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:<br>- përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore<br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:<br>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura **dhe/apo**<br>- gabon në përdorimin e parafjalëve...<br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br>*0 pikë* | përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br><br>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.<br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...<br>*0 pikë* | duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi)<br>*2 pikë*<br><br>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe përfundimi).<br>*0 pikë* |

**25. Skema e vlerësimit të esesë:**

**2. Të studiosh brenda apo jashtë vendit?**

***Përmbajtja 7 pikë***

| | |
|---|---|
| Respektimi i kërkesave të dhëna | Hartimi i një teksti që i përshtatet kërkesave të dhëna:<br>- Rëndësia e studimeve(ngritja e njohurive në nivel më të lartë, konkurrenca më e sigurte për vendin e punës,... *(1 pikë)*<br>- Krahasimi i dy vendeve, mundësitë, përfitimet, të metat, ... *(1 pikë)*<br>- Punësimi, lëmia e studimeve, konkurrenca, numri i kufizuar i vendeve të punës... *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 3 pikë* |
| Mendimi kritik, përdorimi i të dhënave, argumentimi dhe dhënia e qëndrimit personal, mendimit idesë... | Krijimi i tekstit:<br>- qasja origjinale/ kreative ndaj temës *(1 pikë)*<br>- përdorimi dhe lidhja e shembujve relevant gjatë hartimit të temës/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi i hollësishëm dhe lidhja e shembujve/ të dhënave në zhvillimin e temës *(1 pikë)*<br>- argumentimi me fakte dhe qëndrime personale *(1 pikë)*<br>*Gjithsej 4 pikë* |

***Gjuha dhe struktura e tekstit – 6 pikë***

| **GJUHA**<br>***3 pikë*** | **STILI**<br>***2 pikë*** | **FORMA GRAFIKE E TEKSTIT**<br>***1 pikë*** |
|---|---|---|
| Në tekst nuk ka gabime gramatikore dhe drejtshkrimore.<br>*3 pikë*<br><br>Norma drejtshkrimore dhe gramatikore përgjithësisht respektohet dhe është përdorur si e tillë:<br>- përdorimi i shenjave të pikësimit dhe i formulimeve gjuhësore<br>*2 pikë*<br><br>Normat gramatikore dhe | Fjalitë janë ndërtuar qartë dhe janë në përputhje me përmbajtjen dhe formën e tekstit.<br>*2 pikë*<br><br>Në tekst ka gabime stilistike (p.sh. përsëritja e fjalëve të njëjta në një fjali ose në fjalitë që pasojnë/ drejtohet në mënyrë të | Përshtatja e organizimit të tekstit duke përshtatur formën e shkrimit me anën logjike (ndahen qartë hyrja, zhvillimi dhe përfundimi)<br>*2 pikë*<br><br>Mospërshtatja e formës së tekstit strukturës së tij logjike (nuk ndahen hyrja, zhvillimi dhe |

| | | |
|---|---|---|
| drejtshkrimore janë respektuar pjesërisht:<br>- nuk përdoret si duhet gjuha letrare, por e folura dialektore<br>- gabon në përdorimin e shenjave të pikësimit (p.sh. nuk përdor presjen gjatë numërimit, gjatë ndërtimit të fjalive të nënrenditura<br>**dhe/apo**<br>- gabon në përdorimin e parafjalëve...<br>*1 pikë*<br><br>Në tekst ekzistojnë tri apo më shumë gabime thelbësore të gjuhës standarde (përdorimi i gabuar i rasave, gabime në përdorimin e shkronjës së madhe, nuk respekton rregullat e shkrimit të fjalëve bashkë dhe ndaras, zbatimi i njohurive për alternimin e zanoreve, gabon në përdorimin e zanores *ë*, nuk zbaton rregullat sipas të cilave nuk shkruhet bashkëtingëllorja *j*, gabon në përdorimin e trajtës mohuese.<br>*0 pikë* | gabuar/ përdorimi i pleonazmës/ mungesë e të shprehurit/ theksimi i tepruar i të dhënave.<br>*1 pikë*<br><br>Fjalitë nuk janë ndërtuar mirë, janë të paqarta, të papërfunduara...<br>*0 pikë* | përfundimi).<br>*0 pikë* |